

Korçë më 16.04.2019

FTESË PËR OFERTË

Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor

Emri Fondacioni Agjensia Rajonale e Zhvillimit (SME), Korçë
Adresa Rruga “Konferenca e Pezës”, Pall. 1, Korçë, Shqipëri
Tel/Fax +355 822 42626 Cel. 0682034464
E-mail rdakorca@yahoo.com
Faqja e internetit www.rda-korca.org

Fondacioni “Agjensia Rajonale e Zhvillimit (SME)”, Korçë në kuadër të projektit financiar nga UNDEF (The United Nations Democracy Fund - Fondi për Zhvillimin e Demokracisë, Kombet e Bashkuara) me nr. **UDF-17-774-ALB “Tracking Campaign Promises in Albania – Ndjekja dhe verifikimi i premtimeve të fushatës zgjedhore në Shqipëri”** do të zhvillojë procedurën e prokurimit me vlerë të vogël me objekt: “Ndërtim dhe mirëmbajtje e website/portal dhe aplikacioni mobile”.

The Albanian Truth-o-Meter – Matësi Shqiptar i të vërtetës .

Data e zhvillimit të procedurës përzgjedhëse do të jetë 06.05.2019.

Fituesi do të lajmërohet nëpërmjet adresës elektronike në datën 08.05.2019.

Jeni të lutur të paraqisni ofertën tuaj për këtë objekt prokurimi me këto të dhëna (specifikime të shërbimit):

- Ndërtim i website/portal dhe ndërlidhje me aplikacionin mobile;
- Ndërtim aplikacioni mobile për pajisjet smartphone dhe tablet;
- Publikimi i aplikacioneve në Google Play dhe App Store;

Oferta teknike dhe financiare si dhe dokumentacioni mbështetës duhet të dërgohen me postë të zakonshme ose të dorëzohen dorazi në adresën: Fondacioni ARZH Korçë, Lagja 7, Rr. Konferenca e Pezës, Korçë, Shqipëri.

Dokumentacioni të dorëzohet në një kopje origjinale dhe në një fotokopje të futura në zarf secili ku të shkruhet respektivisht “Kopje origjinale” ose “Fotokopje”. Dy zarfat duhet të futen në një zarf të vetëm ku të shkruhet adresa e dërguesit dhe me mbishkrimin “Të hapet nga komisioni vetëm kur të zhvillohet procedura e përzgjedhjes”.

Afati i fundit për pranimin e ofertës është data 03.05.2019, ora 16.00

1. Website/portal dhe aplikacioni duhet të ketë këto funksionalitete:

- a. Faqe të pakufizuara;
- b. Modul artikujsh;
- c. Modul multimedia (foto, video, prezantime, atj);
- d. Modul kontakti online;
- e. Gjuha shqipe;

2. Kërkesat funksionale

Fondacioni “Agjensia Rajonale e Zhvillimit (SME)”, Korçë kërkon të realizojë një website/portal dhe aplikacion për smart phone dhe tablet për menaxhimin e përmbajtjes dhe njoftimeve të cilat do të publikohen për përdoruesit e aplikacionit.

Më poshtë po paraqesim kërkesat funksionale që duhet të plotësojë website/portali dhe aplikacioni mobile për menaxhimin e përmbajtjes.

Kushte të përgjithshme

Portali online “Matësi Shqiptar i të vërtetës”, i emërtuar “Matësi Elektorale” dhe i shfaqur në www.elektor.al do të ndahet në pesë seksione, të cilat do të shërbejnë si butona të menisë kryesore:

- a. **Seksioni “Rreth nesh”:** Ky seksion do të paraqitë një përmbledhje të qartë mbi projektin, ndërkohë që fokusohet në objektiva të qarta që lidhen me portalin online. Kjo do të ofrojë një video promocionale dhe një nën-seksion të detajuar mbi mënyrën se si do të funksionojë procesi metodologjik i filtrimit dhe kategorizimit të premtimeve elektorale. Seksioni Rreth nesh do të orientojë lehtësisht çdo person që hyn në portal duke mundësuar navigimin/lundrimin me lehtësi nëpër seksionet dhe nën-seksionet e tjera.
- b. **Seksioni “Matësi”:** Ky seksion do të jetë pjesa më e rëndësishme e portalit online të Matësit të së Vërtetës. Kjo do të konsistojë në të gjitha premtimet dhe rezultatet politike, ndërkohë që do të vendoset në mënyrë metodologjike nëse secila prej tyre është “arritur”, “arritur pjesërisht”, “nuk është arritur” ose është “e pamatshme”. Në këtë seksion do të

aplikohen filtrat sipas arritjeve së bashku me referencat dhe një sistem grafik të unifikuar (interface).

- c. **Seksioni “Të zgjedhurit”:** Ky seksion do të përfshijë një listë nga A në Z të 201 zyrtarëve të zgjedhur (61 kryetarë bashkie ose kandidatë bashkiakë që garojnë për këtë pozicion, dhe 140 anëtarë të Parlamentit të mbështesin dhe punojnë në çdo bashki, përpara, gjatë dhe pas zgjedhjeve lokale të vitit 2019). Ky seksion do të sigurojë biografi dhe infografe për secilin prej 201 politikanëve, ndërkohë që ata lidhen dhe renditen sipas nivelit të përmbushjes së premtimeve elektorale në 4 vitet e fundit (një lidhje me seksionin Matësi sipas emrit të personit).
- d. **Seksioni “Buxheti Bashkiak”:** Ky seksion do të ofrojë versione të thjeshtuara, lehtësisht të lexueshme të buxheteve bashkiake sipas një liste nga A në Z të bashkive.
- e. **Seksioni “Kontakt”:** Ky seksion do të përfshijë një formë të thjeshtë kontakti, me anë të së cilës qytetarët kanë mundësi të ngrejnë probleme, të shkruajnë rreth premtimeve politike që do të donin t’i kontrollonim ne, ose thjesht të kontaktojnë me Fondacionin Agjencia Rajonale e Zhvillimit, Korçë.

Së fundi, portali online do të zhvillohet vetëm në gjuhën shqipe.

Seksioni “Rreth Nesh”: Nën-menuja

Seksioni “Rreth Nesh” do të ndahet në dy butona nën-menu:

- **Projekti ynë:** Kjo nën-menu do të hapet me një video promovionale e cila do të përshtatet sipas projektit për të ofruar një eksperiencë navigimi të lehtë për përdoruesit, pra, duke maksimizuar kohën e shpenzuar nga njerëzit që hyjnë në portal. Ky nën-seksion do të shpjegojë projektin, misionin, qëllimet dhe informacione të tjera që lidhen me Matësin e së Vërtetës.
- **Metodologjia:** Kjo nën-menu do të përshkruajë metodologjinë e përdorur për procesin e përzgjedhjes dhe kategorizimin e premtimeve politike në: “të arritura”, “të arritura pjesërisht”, “të paarritura” ose “të pamatshme”. Ky nën-seksion do të jetë shumë i dobishëm jo vetëm për akademikë që kërkojnë të analizojnë vlefshmërinë e premtimeve, por edhe për gazetarë dhe grupe të tjera të interesit.

Seksioni “Matësi”: Nën-menuja

Seksioni “Matësi” do të ndahet në pesë butona nën-menu, kryesisht filtra të cilët do të ndihmojnë përdoruesit të gjejnë shpejt premtimet elektorale që kërkojnë:

- **Të gjitha premtimet:** Kjo nën-menu do të tregojë një listë të pafiltruar të të gjitha premtimeve elektorale të identifikuar sipas datës së postimit, edhe nëse janë arritur, janë

arritur pjesërisht ose nuk janë arritur. Çdo premtim do të konsistojë në një fotografi/emër të politikanit që ka dhënë atë premtim (duke përfshirë një hyperlink, i cili kur klikohet do ta drejtojë përdoruesin në faqen e biografisë së atij politikani) në anën e majtë të ekranit, citimi i premtimit në qendër të ekranit (me hyperlink, që kur klikohet mbi të do të drejtojë përdoruesin në një analizë më të gjatë të premtimit) dhe një ikonë që përshkruan nëse premtimi është arritur, është arritur pjesërisht, nuk është arritur apo është i pamatshëm në anën e djathtë të ekranit.

- **Premtime të arritura:** Kjo nën-menu do të filtrojë dhe do të shfaqë vetëm premtimet e arritura. Do të aplikohet i njëjti dizajn si më lart.
- **Premtime të arritura pjesërisht:** Kjo nën-menu do të filtrojë dhe do të shfaqë vetëm premtimet e arritura pjesërisht. Do të aplikohet i njëjti dizajn si më lart.
- **Premtime të paarritura:** Kjo nën-menu do të filtrojë dhe shfaqë vetëm premtimet e paarritura. Do të aplikohet i njëjti dizajn si më lart.
- **Premtime të pamatshme:** Kjo nën-menu do të filtrojë dhe shfaqë vetëm premtimet e pamatshme. Do të aplikohet i njëjti dizajn si më lart.

Seksioni “Të zgjedhurit”: Nën-menuja

Seksioni “Të zgjedhurit” nuk do të përmbajë ndonjë nën-menu. Kur të klikohet mbi të, ai do ta drejtojë përdoruesin tek një faqe tjetër nga A në Z e cila do të përmbajë një listë emërore prej 201 zyrtarësh të zgjedhur. Butoni “Kërko” do ta lehtësojë gjetjen e politikanit specifik. Kur klikohet mbi të, fotot dhe emrat do të drejtojnë përdoruesin në faqen biografike të atij politikani. Faqja biografike do të sigurojë tre burime kryesore informacioni:

- Një biografi e përgjithshme / CV e atij personi;
- Një listë e çdo premtimi të dhënë, specifike për atë politikan (do të aplikohet i njëjti dizajn i përmendur tek nën-seksioni Të gjitha premtimet”).
- Një infograf (imazh), që tregon normën / përqindjen / statistikat e premtimeve të bëra/premtime të arritura, pjesërisht të arritura, ose të paarritura të atij politikani gjatë katër viteve të fundit.

Seksioni “Buxheti Bashkiak”: Nën-menuja

Seksioni “Buxheti Bashkiak” nuk do të përmbajë nën-menu. Kur klikohet në të, përdoruesi do të drejtohet në një listë nga A në Z të 61 bashkive. Kur klikohet mbi secilën, do të hapet një version i thjeshtuar të buxhetit vjetor të asaj bashkie. Në fund të çdo artikulli mbi buxhetin, do të jetë një link drejt versionit aktual të gjatë të buxhetit bashkiak.

Seksioni “Kontakt”: Nën-menuja

Seksioni “Kontakt” do të përmbajë dy nën-menu:

- **Na kontaktoni:** Një formë e thjeshtë kontakti (emri/mbiemri, adresa e e-mailit dhe pjesa ku shkruhet teksti). Në fund të faqes, do të paraqitet informacioni i kontaktit me ARZH Korçë.
- **Sugjeroni fakte ose korrigjime:** Një tjetër formë kontakti në të cilën përdoruesit mund të dërgojnë fakte ose korrigjime.

Informacion shtesë mbi Matësin e së Vërtetës:

Informacion mbi politikat:

Pjesa e poshtme do të përmbajë adresa të cilat shfaqin Politikat e Privatësisë dhe Termat dhe Kushtet e faqes së Internetit.

3. Specifikime teknike për aplikacionin mobile

Aplikacioni mobile duhet të funksionojë për pajisjet smart phone me sistem operimi Android për versionet e tij mbi 4.4 dhe sistem operimi iOS mbi versionin 6.0. Aplikacioni mobile duhet të ofrojë ndërfaqe të përshtatshme me resolutionin e pajisjes smart phone nga e cila aksesohet.

Kompania zbatuese duhet të garantojë që aplikacioni i ofruar nuk ngarkon automatikisht të dhëna konfidenciale të përdoruesve si psh: pozicioni gjeografik, emrin dhe mbiemrin, kontakte në adresar etj. në asnjë sistem tjetër kompjuterik.

Kompania zbatuese duhet të garantojë që aplikacioni i ofruar nuk shfaq reklama apo njoftime përveç informacionit dhe njoftimeve të publikuara nga specialistët e ARZH në website/portal për menaxhimin e përmbajtjes.

3.1. Specifikime teknike për portalin e menaxhimit të përmbajtjes:

- Website/portali i menaxhimit të përmbajtjes mund të jetë i bazuar në sisteme CMS si psh Wordpress, Joomla, Drupal etj.
- Website/portali i menaxhimit të përmbajtjes duhet me doemos që të jetë i ndërlidhur në kohë reale me aplikacionin mobile.
- Website/portali i menaxhimit duhet të instalohet në sisteme operimi Windows apo Unix based.
- Website/portali duhet të ofrojë aksesim të tij nëpërmjet shfletuesve si Google Chrome, Firefox, Internet Explorer, Safari etj.
- Website/portali duhet të jetë funksional në gjuhën shqipe.
- Website/portali duhet të jetë aktiv në të gjitha pajisjet mobile dhe i përshtatur për çdo pajisje tjetër teknologjike.

- Përfshirja e rrjeteve sociale (Facebook, Twitter, LinkedIn).
- Të gjitha elementet e përdorura duhet të jenë të përditësuara në versionin e fundit.

4. Planifikimi i Buxhetit për ndërtimin e sistemit

Më poshtë paraqitet buxheti i planifikuar për të gjithë komponentët e sistemit që do ndërtohet si dhe për trajnimet e nevojshme të përdoruesve.

Nr.	Emërtimi	Sasia	Fondi Limit
1	Zhvillim i website/portal për menaxhimin e përmbajtjes	30 ditë 1 website/portal	2400 USD\$
2	Zhvillim i aplikacionit mobile dhe menaxhimi i përmbajtjes	30 ditë 1 aplikacion	2400 USD\$
TOTALI ME TVSH (LEKË)			4800 USD\$

5. Afati kohor i implementimit të sistemit

Bazuar në komponentët e kërkuar të sistemit dhe nga studimi që ka bërë ARZH, vlerësohet që implementimi i këtij projekti për ndërtimin e sistemit informatik me funksionalitetet e përshkruara sa më sipër dhe trajnimin e stafit të zgjasë 4 javë. Në vijim po e paraqesim procesin në formën e një diagrame Gant duke e ndarë projektin në nivel të proceseve kryesore që pritet të zhvillohen:

Nr.	Emërtimi i fazës / Periudha kohore(ditë)	J1	J2	J3	J4
1	Zhvillimi i portalit Web për menaxhimin e përmbajtjes				
2	Zhvillimi i aplikacionit mobile				
3	Asistimi në krijimin e llogarive Google Play, App Store, publikimin e aplikacionit mobile.				
4	Testimi brenda institucionit i sistemit				
5	Marrja në dorëzim				

6. Kërkesa të tjera

- FARZH ka të drejta të plota mbi dizenjimin dhe përmbajtjen e faqes.
- Të jetë pa gabime sipas standardeve ndërkombëtare.
- Publikimi i të gjithë informacionit paraprak në webfaqe dhe krijimi i kategorive dhe nënkategorive të tyre.
- Operatori Ekonomik të realizojë shtimin e zonës së administrimit, me qëllim që të krijohet mundësia e ndryshimit të informacionit të hedhur në website sa herë që të jetë e nevojshme.

7. Mirëmbajtje

Kontraktuesi duhet të ofrojë mbështetje dhe mirëmbajtje për sistemin për një periudhë **2 (dy) vjeçare** nga data e nënshkrimit të kontratës.

8. Kriteret për kualifikim të Operatorëve Ekonomikë:

Operatori ekonomik i renditur i pari, përpara se të shpallet fitues, duhet të dorëzojë pranë Fondacionit ARZH, dokumentet si më poshtë:

- Ofertuesi duhet të jetë i regjistruar në regjistrat përkatës profesionalë ose tregtarë të shtetit në të cilin ata janë themeluar, duke vërtetuar personalitetin e tyre ligjor.
- Ofertuesi duhet të ketë të përfshirë në objektin e veprimtarisë së tij shërbime në fushën e teknologjisë së informacionit dhe të ketë minimalisht 3 vjet aktivitet sipas regjistrat tregtar, të vërtetuar sipas Ekstraktit të Regjistrat Tregtar.
- Ofertuesi duhet të provojë se nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv);
- Operatori ekonomik duhet të paraqesë dy kontrata me anë të të cilave të vërtetojë kryerjen e shërbimeve me natyrë të ngjashme.

Afati i realizimit të shërbimit do të jetë 4 javë duke filluar nga momenti i nënshkrimit të kontratës.

Në ofertën e tij, ofertuesi duhet të paraqesë të dhënat e plota të personit të kontaktit.